



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM  
Nr. 49 datë 31.07.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 55, DATË 29.12.2023, "PËR MIRATIMIN E  
BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR", TË NDRYSHUAR;**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja (n) të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjit Nr. 68/2017 "Për financat vendore", i ndryshuar; ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKB Nr.60 datë 28.12.2020 "Mbi miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Shkodër", Udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; ligjit Nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", ligjit Nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake", VKB Nr. 54, datë 29.12.2023 "Për një ndryshim në VKB Nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 .., VKB Nr. 55, datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin në numrit total të punonjësve të bashkisë Shkodër, sipas tabelës Nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Fondi i pagave për punonjesit shtesë të bashkisë Shkodër përballohet nga buxheti i bashkisë viti 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 29 vota  
Vota Pro 29  
Vota Kundër 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 01.08.2024



**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Ishte  
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	583	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
<b>TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta )</b>		<b>979</b>	<b>20</b>
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
<b>TOTALI</b>		<b>999</b>	<b>20</b>

Bëhet  
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	603	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
<b>TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta )</b>		<b>999</b>	<b>20</b>
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
<b>TOTALI</b>		<b>1,019</b>	<b>20</b>

Sekretare  
Sabina Danaj

